



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

**QENDRËS KOMBËTARE TË KËRKIM SHPËTIMIT
DHE FEDERATËS SHQIPTARE TË ALPINIZMIT DHE TURIZMIT
MALOR
PËR**

**KOORDINIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NË OPERACIONET E
KËRKIM SHPËTIMIT NË RAJONIN E KËRKIM SHPËTIMIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

TIRANË 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MBROJTJES

Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit

(QKKSH)

Federata Shqiptare e Alpinizmit

dhe Turizmit Malor

(FSHALTM)

Nr 120...Prot, datë 24.02.2026

Nr 41...Prot, datë 24.02.2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

QENDRËS KOMBËTARE TË KËRKIM SHPËTIMIT

DHE

FEDERATËS SHQIPTARE TË ALPINIZMIT DHE TURIZMIT MALOR KOORDINIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NË OPERACIONET E KËRKIM SHPËTIMIT NË RAJONIN E KËRKIM SHPËTIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

HYRJE

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (në vijim referuar si “Marrëveshje”) është hartuar nga dhe ndërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtimit (QKKSH) në Ministrinë e Mbrojtjes në RSH (në vijim referuar si “QKKSH”) dhe Federatës Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor (në vijim referuar si “FSHALTM”). Së bashku në vijim referuar si “Palët”.

Organizimi i shërbimit të kërkim-shpëtimit dhe detyrimet e Republikës së Shqipërisë për këtë shërbim përcaktohen nga konventat ndërkombëtare dhe aktet ligjore e nënligjore të ratifikuara e miratuara nga autoritetet e vendit tonë.

Në kontekstin e përfaqësimit të tyre ligjor dhe institucional në mbështetje të legjislacionit në fuqi (kombëtar dhe ndërkombëtar) për menaxhimin, koordinimin dhe kryerjen e operacioneve të Kërkim Shpëtimit (Search And Rescue-SAR) në Rajonin e Kërkim Shpëtimit të Republikës së Shqipërisë.

Duke njohur nevojën e bashkëpunimit për arritjen e objektivave primar të tyre të cilat janë shpëtimi i jetës njerëzore në rast të një aksidenti SAR.

Duke menduar se një Marrëveshje Bashkëpunimi do të ndihmojë në mënyrën më efektive të mundshme në rast aksidenti SAR.

Duke mbajtur parasysh referencat e mëposhtme ligjore:

- Dekret i Presidentit nr. 7438, datë 1.12.1990, “Për aderimin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në Konventën për Aviacionin Civil Ndërkombëtar (ICAO) dhe në protokollin për tekstin autentik tre gjuhësh të kësaj konvente.
- Konventa Ndërkombëtare e Aviacionit Civil “ICAO” (Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil), Chikago 1944, ICAO Aneks 12 “Kërkim shpëtimi”;
- Ligji nr. 96/2020 Kodi Ajror i Republikës Së Shqipërisë;
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
- Ligji nr.10435, datë 23.06.2011 “Për shërbimin e kërkim-shpëtimit (SAR) në Republikën e Shqipërisë në rast aksidentesh ajrore dhe detare”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 742, datë 16.10.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit”;
- Ligjit nr.79/2017, datë 27.04.2017 “Për Sportin”.
- Ligjit nr.8788, date 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”.

DUKE QENE SE:

Palët ndajnë vizionin e mundësimit të forcimit të bashkëpunimit në lidhje me bashkëpunimin, koordinimin dhe ndihmën në operacionet e kërkim shpëtimit në Rajonin e Kërkim Shpëtimit të Republikës së Shqipërisë.

QKKSH dhe FSHALTM, angazhohen plotësisht për zbatimin e kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje.

Të dyja palët janë të detyruara të koordinojnë ndërmjet tyre për çdo ndryshim të statusit operacional apo të mjeteve të tyre të operimit, të cilat ndikojnë në procedurat e specifikuar në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

PËR KËTË ARSYE, Palët bien dakord si më poshtë:

Përkufizime

Përkufizimet e mëposhtme do të aplikohen në këtë Marrëveshje:

“Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit (SAR)”	është Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit, që nënkupton strukturat, sistemet e vrojtimit, personelin dhe mjetet për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.
“Kërkim”	Një operacion, zakonisht i koordinuar nga një qendër e koordinimit të shpëtimit, duke përdorur personelin dhe mjetet në dispozicion për të gjetur personat në rrezik.
“Shpëtim”	Operacioni i zhvendosjes/i marrjes së personave në rrezik, mbështetja e tyre me nevojat bazë mjekësore ose nevoja të tjera, si dhe dërgimi i tyre në një vend të sigurt.
“Rast kërkim-shpëtimi”	Çdo fatkeqësi e mundshme apo që ka ndodhur për të cilën një strukturë SAR ka krijuar një dosje dokumentesh, megjithëse burimet SAR nuk janë aktivizuar.
“Incident kërkim- shpëtimi”	Çdo situatë që kërkon informimin dhe njoftimin e sistemit SAR dhe që mund të kërkojë operacionet SAR.
“Qendra e koordinimit të shpëtimit”	Qendra nga e cila një incident SAR kontrollohet dhe koordinohet. Kjo qendër njihet me terma të ndryshëm të tillë, si Qendra e Koordinimit të Shpëtimit, Zyra e Incidenteve Madhore, Zyra e Operacioneve. Për qëllimet e kësaj Marrëveshje, kjo qendër quhet Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit (QKKSH) ose RCC.
“Njësia e kërkimit dhe e shpëtimit”	Një njësi e përbërë nga personeli i trajnuar mirë dhe i pajisur me pajisje të përshtatshme për kryerjen e shpejtë të operacioneve të kërkim-shpëtimit.
“Koordinimi”	Bashkimi i strukturave dhe elementeve SAR, për të siguruar përgjigje efikase të kërkim-shpëtimit. Një njësi SAR duhet gjithmonë të ketë përgjegjësinë e përgjithshme të koordinimit dhe strukturat e tjera duhet të bashkëpunojnë me këtë njësi për të dhënë përgjigjen më të mirë të mundshme me burimet që kanë dispozicion.
“Vendngjarje”	Zonë kërkimi ose vendi aktual i rrezikut.

“Koordinator në vendngjarje”

Një person i caktuar për të koordinuar operacionet e kërkimit dhe të shpëtimit brenda një zone të specifikuar.

“Komunikimet koordinuese të kërkim-shpëtimit”

Komunikimet e nevojshme për koordinimin e strukturave që marrin pjesë në një operacion të kërkimit dhe të shpëtimit.

Neni 1

Palët

1. **Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit (QKKSH)**, me adresë Rruga e “Dibrës”, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari i QKKSH-së Kolonel Fiqiri Hoxha, është person juridik publik, në vartësi të Ministrit të Mbrojtjes, dhe ka për mision menaxhimin dhe koordinimin në nivel kombëtar të operacioneve të kërkim-shpëtimit në hapësirën tokësore, detare dhe ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë, në rast aksidentesh ajrore dhe detare.
2. **Federata Shqiptare e Alpinizmit dhe Turizmit Malor (FSHALTM)**, me NIPT K51730014U, është një organizatë Sportive, humanitare e vullnetare që e ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavarur, në bazë të ligjit Nr.7864, i ndryshuar, dhe në bazë të ligjit nr.79/2017, datë 27.04.2017 “Për Sportin”, Kodit Civil, ligjit nr.8788, date 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet dhe është e vetmja organizatë e njohur ligjërisht nga Shteti Shqiptar, për të zhvilluar, administruar dhe organizuar të gjitha llojet e disiplinave që përfshin sporti i Alpinizmit në Republikën e Shqipërisë. FSHALTM në sajë të degëve të shtrira në mbarë vendin dhe 2.500 vullnetarëve të vet, shoqata është e pranishme në shoqërinë shqiptare kudo ku ka nevoja humanitare, në mënyrë të veçantë gjatë emergjencave të ndryshme. FSHALTM ka treguar vlerat në organizimin e operacioneve të ndihmës humanitare gjatë katastrofave dhe krizave që kanë prekur vendin tonë, duke ndihmuar një numër të madh njerëzish të prekur dhe në nevojë.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe angazhimi i dy institucioneve në kuadër të operacioneve të kërkim shpëtimit në Rajonin e Kërkim Shpëtimit të Republikës së Shqipërisë në rast aksidentesh ajrore në terrene malore dhe kushte ekstreme të motit me dëbore, si dhe në kanione, shpella, përrenj dhe lumenj.

Neni 3

Objekti i marrëveshjes

Bashkëpunimi ndërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtimit dhe Federatës Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor për mbarëvajtjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit në hapësirën tokësore dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë, me qëllim minimizimin e pasojave dhe eliminimin e humbjeve në jetët njerëzore.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtimit

- 1.Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit, koordinon në nivel kombëtar, operacionet e kërkim-shpëtimit në hapësirën tokësore, detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë.
- 2.Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit është pikë kombëtare kontakti për operacionet e kërkim-shpëtimit në rast aksidentesh ajrore dhe detare. Ajo bashkëvepron me institucionet shtetërore, subjektet private dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe përgjigjet për detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e kërkim-shpëtimit SAR në zonën e përgjegjësisë.
- 3.Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit monitoron situatën ajrore dhe detare 24/7 dha ka të deklaruar në ICAO Pikën e Kontaktit SAR/SPOC, e cila është e vendosur në një ambient të përbashkët me AKMC në Sallën Operacionale të Emergjencave Civile.
- 4.Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën e Kontrollit të Misionit satelitor Cospas-Sarsat në Bari, Itali, nga e cila merr në kohë reale të dhëna mbi aksidentet SAR nëpërmjet pajisjeve sinjalizuese të përdorura nga mjetet ajrore (ELT/Emergency Locator Transmitter), nga mjetet detare (EPIRB/Emergency Position Indicating Radio Beacon) dhe PLB (Personal Locator Transmitter).
- 5.Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit, në rast të marrjes së një sinjali satelitor pas vlerësimit të informacionit, për çështje që lidhen me fushën e përgjegjësisë të FSHALTM, koordinon dhe kërkon bashkëpunim për operacionin e kërkimit dhe shpëtimit.
6. Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit shfrytëzon kapacitetet dhe pajisjet e FSHALTM në rast të aksidenteve ajrore dhe detare.
- 7.Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit merr pjesë në seminare trajnuese/konferenca të përbashkëta, workshop të organizuara.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Federatës Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor

1. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje Federatës Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor, merr përsipër të bashkëpunojë me QKKSH gjatë operacioneve të kërkim-shpëtimit.
2. Në rast të aksidenteve ajrore terrene malore dhe kushte ekstreme të motit me dëbore, si dhe në kanione, shpella, përrenj dhe lumenj etj, bashkëpunon me QKKSH dhe vendos në dispozicion të saj personelin (vullnetarët) dhe pajisjet në gjithë territorin e RSH-së.
3. Të marrë pjesë në mënyrë aktive në fushatat mbi informimin dhe edukimin mbi operacionet e kërkim-shpëtimit në terrene të vështira.
4. Do të vendosë në dispozicion stafin trajnues dhe përfshijë FSHALTM në stërvitjet e organizuara nga QKKSH.
5. Do të mbështesë nëpërmjet burimeve të veta njerëzore dhe teknike, trajnimet dhe stërvitjet për menaxhimin e aksidenteve në terrene të vështira.
6. Të angazhohet për pjesëmarrje në takime, workshope, seminare, trajnime të ndryshme të organizuara nga QKKSH.

Neni 6

Bashkëpunimi

Palët do të bëjnë përpjekjet më të mira për të bashkëpunuar dhe përmbushur të gjitha detyrimet sipas kësaj marrëveshje me të gjithë kujdesin e duhur si dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

Neni 7

Forca Madhore

Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit dhe Federatës Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor, nuk do të mbajnë përgjegjësi për ndonjë dështim apo vonesë në përmbushjen e kushteve të kësaj marrëveshje, për arsye të Forcës Madhore.

Neni 8

Rishikimi

Marrëveshja përbën të gjithë bashkëpunimin e Palëve dhe asnjë kusht, detyrim, apo marrëveshje e cila ka për qëllim të modifikojë kushtet e kësaj Marrëveshje, nuk do të jetë i detyrueshëm për tu zbatuar përveç rasteve kur bëhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga të dyja Palët.

Neni 9

Komunikimi

1. Palët komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme ndërmjet tyre dhe shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e angazhimeve të tyre, sipas kësaj marrëveshje. Komunikimi do të kryhet në adresat e mëposhtme me telefon celular në formë shkresore dhe/ose nëpërmjet postës elektronike.

QKKSH

- Adresa: Adresa: Rruga e Dibrës, Tiranë, Kutia postare 2423;
- Ndërtesa e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së;
- Mobile: +355 68 804 8838;
- Tel: +355 4224 0081;
- Faks +355 4224 0087;
- E-mail: nsarc@aaaf.mil.al; qkksh@mod.gov.al;

FSHALTM (sipas degëve me përfaqësues në gjithë vendin):

Lista e drejtuesve dhe kryetarëve të grupeve të Kërkim-Shpëtimit Malor Shqiptar:

- ❖ Nertil Ziu – Kryetar i Shërbimit të Kërkim-Shpëtimit Malor
+355 69 731 4312; nertilziu87@gmail.com
- ❖ Blerim Ceka – Nënkryetar i Shërbimit të Kërkim-Shpëtimit Malor
+355 67 405 7125; blerimcc@gmail.com
- ❖ Sajmir Kalbaj – Kryetar i grupit në Valbonë
+355 68 505 3030; saimirkalba@gmail.com
- ❖ Enis Shehu – Kryetar i grupit të Tiranës
+355 69 248 2309; enissgehu123@gmail.com
- ❖ Orgest Cara – Kryetar i grupit të Peshkopisë
+355 68 244 1162; orgestcara@yahoo.com
- ❖ Alket Camaj – Kryetar i grupit Shkodër-Theth
+355 67 306 9660
- ❖ Paulin Polia - Theth
+355 69 301 6781
- ❖ Dionis Bica – Kryetar i grupit të Elbasanit
+355 67 220 0200; dioni100@yahoo.it
- ❖ Nevila Ferro – Kryetare e grupit të Vlorës
+355 69 993 2115
- ❖ Vasil Cekani – Kryetar i grupit Gjirokastrë-Përmet
+355 69 435 1276
- ❖ Gazmend Shehu – Kryetar i grupit të Beratit
+355 69 237 7297
- ❖ Iljon Thanasi – Kryetar i grupit Korçë-Pogradec
+355 69 217 0848

Neni 10

Konfidencialiteti

Secila palë do të ndërmarrë të gjitha masat paraprake të përgjegjësisë të nevojshme për të mbrojtur informacionin e marrë sipas kësaj marrëveshje nga bërja publike në formë të pa autorizuar. Palët bien dakord të mbikëqyrin në masën e kërkuar sipas legjislacionit të aplikueshëm, rregullat dhe rregulloret e tyre përkatëse, mbrojtjen e informacionit të marrë nga Pala tjetër.

Neni 11

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e kësaj Marrëveshje fillon në datën e nënshkrimit të tij dhe do të zgjasë deri në një afat të pacaktuar, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet palëve në formë të shkruar.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Marrëveshja mund të zgjidhet në çdo kohë nga secila palë. Zgjidhja e Marrëveshjes do të jetë efektive kur njëra palë njofton palën tjetër përkatësisht në formë të shkruar 3 (tre) muaj para në rast se njoftimi në fjalë për zgjidhje të Marrëveshjes, nuk është tërhequr/anuluar me miratimin e palëve përpara përfundimit të afatit. Ajo përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, nga 1 (një) për secilën palë.

Nënshkruar në TIRANE me datën 24.02.2026

**QENDRA KOMBËTARE E KËRKIM
SHPËTIMIT**

**KOLONEL FIQIRI HOXHA
KRYETAR**



**FEDERATA SHQIPTARE E ALPINIZMIT
DHE TURIZMIT MALOR**

**Z.ARTUR GUNI
PRESIDENT**

